ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**TU-24-9473-1-1-1**
Nr i brendshëm	**TU-24-026-111**

Sa i përket tenderit për: "Furnizim me AD-BLUE".

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

GETNO L.L.C; RGB SH.P.K; GRAMI SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Imzot Nikprelaj, Ulpiana, Nr.12

(Adresa)

Prishtinë **10 000**

(Vendi) *(Kodi postar)*

+38349676772

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Etnik Çitaku

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

getnollc@gmail.com

(Adresa elektronike)

16.06.2025

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 11.09.2024 Hapja e ofertave: 04.11.2024 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 29.05.2025 Kërkesa për rishqyrtim e dt:03.06.2025 Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 04.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për Kontratë është bërë me dt. 11.09.2024, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 04.11.2024, ku kanë qenë 7 ofertues, ndërsa ne kemi qenë OE me çmimin më të lirë.
Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me dt. 29.05.2025 ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, kurse neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Sipas vendimit te OSHP Ju si Operator Ekonomik, nuk keni përmbushur kërkesën administrative për dorëzimin e garancisë së sigurimit të tenderit, pasi nuk e keni ngarkuar atë në platformën e e-prokurmit, siç kërkohet nga procedurat përkatëse, por e keni dorëzuar në formë fizike.

Arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, njëkohësisht edhe referimi i AK-së tek vendimi i OSHP-së me nr.202/2025 është i gabuar për faktin se konstatimet e panelit shqyrtues të OSHP-së nuk janë bërë në

mënyrë të drejtë dhe njëkohësisht nuk janë analizuar në tërësi dëshmitë dhe faktet konkrete në lidhje me vlerësimin e pretendimeve të OE ankues, andaj këto fakte do ti sqarojmë më poshtë:

Kronologji:

Data e hapjes së ofertave për këtë aktivitet të prokurimit ka qenë me 04.11.2024, ndërsa ne me ofertë po në këtë ditë kemi dorëzuar edhe sigurimin e tenderit i cili ka qenë valid deri me dt.04.03.2025.
Me dt.29.01.2025, AK-ja ka ngarkuar në sistem kërkesën për zgjatjen e validitetit të ofertave edhe për 60 ditë nga data e skadimit, mirëpo nuk është kërkuar edhe vazhdimi i sigurimit të tenderit (shih më poshtë kërkesën e AK-së):

Aktiviteti i prokurimit " **Furnizim me AD-BLUE**" me nr. te prokurimit: **TU-24-9473-1-1-1** dh te brendshëm: **TU-24-026-111.** është në fazën e shqyrtimit pranë OSHP-së , andaj kërkojmë ju operatoret ekonomik ofertues ne këtë procedure te vazhdoni periudhën e vlefshmëris ofertave edhe për 60 ditë nga data e skadimit,

Sigurimi ynë i dorëzuar me ofertë:

Kjo garanci është e vlefshme prej datës	04.11.2024	deri më	04.03.2025
Lëshuar në	Prishtinë	datë	01.11.2024
Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit			

Pra sipas fakteve të lartcekura AK-ja me dt.29.01.2025 ka kërkuar zgjatje vetëm për validitetin e ofertave, pasi që sigurimi i tenderit ka pasur afat valid. Pra këtu është edhe referimi i gabuar nga ana e panelit shqyrtues të OSHP-së, ku e njëjta në vendimin e saj e ka cekur si në vijim *"Paneli Shqyrtues ka gjetur se AK me datë 29.01.2025 ka ngarkuar kërkesën për zgjatjen e validitetit të ofertës dhe të sigurimit të tenderit. Ndërsa me datë 30.01.2025 tenderuesi i rekomanduar "Getno LLC" ka bashkangjitur një deklaratë për vazhdimin e validitetit të ofertës mirëpo nuk është bashkangjitur edhe sigurimi i tenderit në eprokurim".*
Pra paneli shqyrtues i OSHP-së nuk i ka analizuar në tërësi dëshmitë përkatësisht kërkesën e AK-së të dt.29.01.2025, ku është kërkuar vazhdimi i validitetit të ofertave, mirëpo jo edhe sigurimi i tenderit.

Pasi që me dt.04.03.2025, sigurimit të tenderit të dorëzuar me ofertë do të i skadonte afati dhe pasi që nga AK-ja nuk kishim pranuar ndonjë njoftim për zgjatjen e sigurimit të tenderit, po me këtë datë ne e kemi kërkuar nga kompania e sigurimeve që të bëj vazhdimin e sigurimit të tenderit. Po me këtë datë jemi munduar të bëjmë ngarkimin e sigurimit të vazhduar në sistemin e E-Prokurimit, mirëpo siç edhe dihet me dt.04.03.2025 deri me dt.09.03.2025, platforma E prokurimi ka qenë jashtë funksionit dhe ka qenë e pamundur të bëhet ngarkimi i ndonjë dokumenti. Më poshtë po e bashkangjesim edhe njoftimi nga KRPP në lidhje me këtë problem:

09-03-2025 NJOFTIM PËR OE, AK dhe PUBLIKUN E GJERË

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) njofton të gjithë Operatorët Ekonomik, Autoritetet Kontraktuese dhe publikun e gjerë se problemi teknik me Sistemin Elektronik i raportuar me datë 04/03/2025 tani më është evituar.
Prandaj, duke filluar me datë 09/03/2025, ora 22:30h, Sistemi i Prokurimit Elektronik do të jetë i qasshëm për të gjithë përdoruesit nëpërmjet linkut https://e-prokurimi dhe në disponueshmëri me të gjitha shërbimet.

Pasi që nuk ka qenë e mundur të bëhet dorëzimi i sigurimit, ne si kompani kemi dorëzuar fizikisht formën origjinale të sigurimit të tenderit të vazhduar ku i njëjti është dorëzuar në zyrën e prokurimit dhe njëkohësisht është pranuar nga zyrtarë të AK-së.
Sigurimi i tenderit është dorëzuar dhe i njëjti posedon datën e validitetit nga dt.04.03.2025-04.07.2025, shih dëshminë:

Kjo garanci është e vlefshme prej datës	04.03.2025	deri më	04.07.2025
Lëshuar në	Prishtinë	datë	04.03.2025
Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit	PRISHTINË		

Kompania e Sigurimeve PRISIG SHA / Numri unik identifikues: 810842832 / Tel: +383 (0) 38

Duhet cekur fakti se OSHP-ja në vendimin e saj e ka cekur po ashtu *"Ngjashëm është vepruar edhe me datë 30.04.2025 kur është ngarkuar në eprokurim deklarata për vazhdim të validitetit të ofertës mirëpo nuk është bashkangjitur sigurimi i tenderit".*
Edhe në këtë rast ky konstatim i panelit shqyrtues është i gabuar për faktin se edhe me dt.30.04.2025, AK-ja nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurimit të tenderit, mirëpo edhe në këtë kërkesë është kërkuar vazhdimi i validitetit të ofertave dhe mirëpo jo edhe sigurimit të tenderit, edhe pse realisht sigurimi i tenderit i dorëzuar nga ana jonë në formë fizike ka pasur dhe ka ende validitet edhe pas kërkesës për zgjatje të validitetit të ofertave.

Shih kërkesën nga AK-ja të dt.30.04.2025:

Aktiviteti i prokurimit **" Furnizim me AD-BLUE"** me nr. te prokurimit: **TU-24-9473-1-1-1** d te brendshëm: **TU-24-026-111.** është në fazën e shqyrtimit pranë OSHP-së , andaj kërkojn ju operatoret ekonomik ofertues ne këtë procedure te vazhdoni periudhën e vlefshmër ofertave edhe për 90 ditë nga data e skadimit,

Pra në të dy rastet AK-ja ka kërkuar që të vazhdohet vetëm validiteti i ofertave, mirëpo jo edhe të sigurimit të tenderit.

Ne që nga ofertimi e edhe tani, e posedojmë sigurimin e tenderit me afat valid dhe i njëjti nuk mund dhe nuk duhet të kontestohet, pasi që për asnjë ditë nuk ka pasur ndonjë shkëputje dhe në këtë rast nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemi me ndonjë vendim të tillë, pasi që siç e sqaruam edhe më lartë vendimi i OSHP-së është i lëshuar duke mos u analizuar në tërësi dokumentet e këtij aktiviteti të prokurimit.

Në vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së me nr.202/2025 është dhënë arsyetimi si në vijim:
Eksperti shqyrtues është dashur po ashtu të parashtroj pyetje nëse lidhur me pranimin fizik të dokumentit është mbajtur dhe është nënshkruar procesverbal i pranim/dorëzimit të dokumentit me qëllim që të vërtetohet se dokumenti është dorëzuar pranë AK brenda afatit

ligjor. Po ashtu është dashur që të sqarohet nga AK pse dokumenti nuk është kërkuar/pranuar përmes email adresës me ç'rast do të mund të argumentohej saktësisht koha dhe mënyra e dorëzimit të dokumentit nga OE për AK.

Në lidhje me konstatimin e parë të OSHP-së, ku është shënuar se është dashur të vërtetohet fakti se a është dorëzuar pranë AK-së sigurimi i tenderit brenda afatit ligjor, ju sqarojmë se ky konstatim i të njëjtës është i paqëndrueshëm për faktin se nga vet data e sigurimit të tenderit 04.03.2025, vërtetohet fakti se sigurimi i tenderit është valid dhe nuk ka shkëputje fare, prandaj ky konstatim është i paqëndrueshëm. Gjithashtu nga praktikat siç edhe dihet sigurimi i tenderit, nëse ka shkëputje ndonjë ditë, atëherë kompanitë e sigurimeve e vazhdojnë sigurimin në ditën kur është kërkuar vazhdimi i sigurimit, mirëpo në asnjë mënyrë nuk e aprovojnë vazhdimin e sigurimit me ndonjë datë të mëhershme apo retroaktive.

Ndërsa faktin se pse nuk është kërkuar edhe përmes emailit vazhdimi i sigurimit të tenderit nga ana e AK-së, ky konstatim është diskriminues kundrejt kompanisë tonë, pasi që oferta jonë nuk mund të cilësohet si e papërgjegjshme nëse AK-ja nuk ka kërkuar të dorëzohet edhe përmes emailit. Pra ne nuk mund dhe nuk duhet që në asnjë mënyrë të eliminohemi për arsye të cilat nuk janë në dorën tonë. Se a ka kërkuar AK-ja apo jo që të dorëzohet përmes emailit sigurimi i tenderit, ky fakt nuk na bën neve OE të papërgjegjshëm, pasi që mos kërkesa e AK-së që të bëhet dorëzimi përmes emailit nuk është dhe në asnjë mënyrë nuk mund të cilësohet si faj i yni, prandaj ne nuk duhet të pësojmë për gabime të AK-së apo për mos funksionim të platformës së prokurimit.

Nëse eventualisht ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me vazhdimin e sigurimit të tenderit, atëherë shumë lehtë ka mund të kërkohen sqarime shtesë edhe nga ana e kompanisë së sigurimeve PRISIG, me qëllim që të vërtetohet koha e lëshimit të sigurimit të tenderit.

Nga të gjitha ato që i thamë më lartë, rezulton dhe vërtetohet se ne kemi bërë vazhdimin e validitetit të ofertave sipas kërkesave të AK-së, ndërsa sigurimin e tenderit e kemi vazhduar edhe pse nuk na është kërkuar nga ana e AK-së dhe në pamundësi për të dorëzuar sigurimin e vazhduar përmes prokurimit (jo për fajin tonë, por për shkak të mos funksionimit të platformës) e kemi bërë dorëzimin në formë fizike.

Kur kemi parasysh të gjitha dështimitë dhe faktet e lartcekura kuptohet qartë se ne jemi OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit dhe si i tillë është dashur të rekomandohemi për kontratë dhe jo të eliminohemi me arsyetime të pa bazuara, përkatësisht duke u thirr në vendimin e OSHP-së e i cili vendim siç edhe e cekëm është i lëshuar pa u analizuar të gjitha dështimitë në këtë aktivitet të prokurimit. Kjo është vërtetuar edhe nga sqarimet e lartcekura, ku OSHP-ja ka dhënë konstatime të gabuara duke e cekur se AK-ja ka kërkuar zgjatjen edhe të sigurimit të tenderit, mirëpo që një gjë e tillë është e paqëndrueshme, sepse dy here nga AK-ja është kërkuar vetëm zgjatja e validitetit të ofertave.

Sa për korrektësi ne në kërkesë për rishqyrtim po i prezantojmë edhe një herë vazhdimet e validitetit të ofertave dhe sigurimet e tenderit, njëkohësisht edhe dy

kërkesat e AK-së për vazhdimin e validitetit të ofertave me qëllim që të vërtetohet gjendja faktike.

Anulimi i këtij tenderi përbën diskriminim për kompaninë tonë për shkak se ne jemi ofertues i vetëm i përgjegjshëm dhe i plotësojmë në tërësi kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Ne me dt.04.06.2025 kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që nuk janë dhënë arsye konkrete për një refuzim të tillë.
Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim ka dhënë arsyetimin si në vijim:

> Pas shqyrtimit të vendimit nga **Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP)** gjate vlerësimit ne si AK kemi respektuar vendimin e OSHP duke ju shpallur te papërgjegjshëm për arsyeje se nuk keni ngarkuar ne platforma garancinë e sigurimit te tenderit mirëpo e keni dorëzuar atë ne forme fizike edhe pse ne atë kohe platforma e e-prokurimit ishte jashtë funksionit.

Arsyetimi i AK-së se është respektuar vendimi i OSHP-së dhe për këtë fakt na kanë eliminuar neve si kompani, është arsyetim i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm. Ne e kemi sqaruar edhe më lartë se paneli shqyrtues i OSHP-së me rastin e nxjerrës së vendimit të saj nuk i ka analizuar në tërësi dëshmitë përkatësisht kërkesën e AK-së të dt.29.01.2025, ku është kërkuar vazhdimi i validitetit të ofertave, mirëpo jo edhe sigurimi i tenderit.

Gjithashtu edhe pse nuk ishte kërkuar nga AK-ja vazhdimi i sigurimit të tenderit, vet AK-ja e ka pranuar në arsyetimin e saj se në kohën kur e kemi dorëzuar sigurimin e tenderit të vazhduar platforma e e-prokurimit ka qenë jashtë funksionit. Pra edhe në këtë rast si nga AK-ja e edhe në vendimin e OSHP-së është konstatuar se ne kemi dorëzuar sigurimin e tenderit të vazhduar, andaj është absurde të eliminohemi me arsyetime të tilla.

Autoriteti kontraktues në momentin që e verifikon që në vendimin e OSHP-së nuk janë analizuar në tërësi të gjitha faktet dhe dëshmitë e prezantuara nga ne dhe njëkohësisht janë bërë disa lëshime me rastin e konstatimeve të panelit shqyrtues, atëherë e njëjta nuk duhet të veproj sipas vendimit të panelit mirëpo duhet të sqaroj me argumente konkrete të kundërtën e vendimit të OSHP-së ose më mirë të themi paqartësitë të cilat i ka pasur OSHP-ja me rastin e vendimmarrjes.

Kërkojmë nga OSHP-ja që të analizohen në tërësi të gjitha dokumentet e tenderit (dokumente të cilat po i bashkangjesim edhe në ankesë) dhe pastaj të merret një vendim meritor në lidhje me ankesën tonë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse ne jemi eliminuar pa ndonjë bazë ligjore.

Nga të gjitha dëshmitë dhe sqarimet që u cekën më lartë vijmë në përfundim se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në mënyrë kundërligjore dhe në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Po ashtu nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në nenin 43.5 dhe 43.7 të Rregulloren nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*, mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, sepse ka anuluar aktivitetin e prokurimit pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë dëshmi konkrete, prandaj ky është diskriminim i hapur ndaj kompanisë tonë.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e grupit të OE **GETNO L.L.C; RGB SH.P.K; GRAMI SH.P.K.** si e bazuar,
ANULOHET njoftimi mbi vendimin (B58) e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit, si dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesës në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*